




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. _____	Nr. Prot. _____
Dep. <u>DPK1</u>	Br. Prot. _____
Dep. _____	Prot No. <u>03-02/824/H</u>
Nr. l faq. _____	Data _____
Broj stranica _____	Datum <u>22-03-2017</u>
Nr. pages _____	Date _____
PRISHTINË	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 21.03.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4679/16, për zyrtarin e lartë z. Afrim Prekazi, Anëtar i Bordit në Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOST), për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit dhe mos pajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik .

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-4679/16, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Afrim Prekazi, Anëtar i Bordit në Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOST).

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit, është vërejtur se zyrtari i lartë z. Afrim Prekazi, Anëtar i Bordit në Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOST) figuron si pronar dhe person i autorizuar në bizneset private e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Prekazi, ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së, dhe është interesuar për një takim me zyrtarët e AKK-së për tu njoftuar për situatën që është duke u trajtuar.

Ne takimin e organizuar në zyrat e AKK-së me zyrtarin z. Afrim Prekazi, zyrtarët e AKK-së, e kanë njoftuar zyrtarin e lartë me faktet që posedon Agjencia lidhur me rastin e iniciuar.

z. Prekazi, është pajtuar me gjendjen, por është arsyetuar nuk ka qenë i informuar se kjo situatë është në kundërshtim me ligjin në fuqi, por është zotuar se brenda afatit ligjor do të bëjë ndryshimet dhe do të veprojë sipas ligjit në fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Pas kësaj shkrese, nga z. Afrim Prekazi, kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se z. Afrim Prekazi, nuk figuron me si person i autorizuar në bizneset private me emër N.T.P “Kabell Sat” dhe nr.70175437, dhe N.T “Satelit” nr.80607091.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga z. Afrim Prekazi, Anëtar i Bordit në Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOST), duke bërë ndryshimet e parapara, duke hequr dorë nga përgjegjësit dhe të drejtat e funksionit si personi i autorizuar në bizneset private janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Afrim Prekazi, Anëtar i Bordit në Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOST), dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shqip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

